

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – Kolegji i veçantë i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar dhe gjyqtarët: Avdi Dinaj, Meleqe Behxheti, Nebojsa Boriçiq dhe Nazmije Ibrahim, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. H. nga Prizreni, për veprat penale: vrasje e rëndë e parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 11 të KPK dhe mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK, lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, ankesave të përfaqësuesve të të dëmtuarave Sh. D. dhe T. H., avokatëve B. S. dhe R. K., nga Prizreni, ankesës së të dëmtuarit I. S., ankesës së të akuzuarit M. H. dhe ankesës së mbrojtësit të tij, avokat H. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr. 64/2009 datë 5 maj 2010 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 245/2010, datë 9 qershor 2011, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, më datë 15 mars 2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, si dhe ankesave të përfaqësuesve të palës së dëmtuar, Sh. D., T. H. dhe I. S., aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr. 64/2009, datë 5 maj 2010 dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 245/2010 datë 9 qershor 2011, ndryshohen përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarin M. H., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 40 (dyzet) vjetësh, në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 19 dhjetorit 2008 e tutje.

Ankesa e të akuzuarit dhe ajo e mbrojtësit të tij refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktgjykimin P.nr. 64/2009, datë 5 maj 2010, e ka shpallur fajtor të akuzuarin M. H. për veprën penale vrasje e rëndë, të parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 11 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK, për

të cilat e ka gjykuar me dënim burgimi afatgjatë në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vitesh, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 9 dhjetorit 2008 e tutje, duke e detyruar të akuzuarin që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 2.000 € në emër të shumës paushalle. Ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënimin plotësues - marrjen e pushkës gjysmë-automatike të tipit "SKS", me nr.serik 14148147, kal. 7,62x39 mm, si mjet me të cilin janë kryer veprat penale. Të dëmtuarit Sh. D., T. H. dhe I. S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, i ka udhëzuar në kontest civil.

Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, ankesat e përfaqësuesve të palëve të dëmtuara dhe asaj të mbrojtësit të të akuzuarit, paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë, me aktgjykimin Ap.nr.245/2010, datë 9 qershor 2011, ka vendosur:

"Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, mbrojtësit të të akuzuarit M. H., përfaqësuesve të autorizuar të të dëmtuarve T. H., Sh. D., I. S., kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr. 64/2009, datë 5 maj 2010, vërtetohet".

Kundër këtij aktgjykimi dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, ankesa kanë paraqitur:

- Prokurori Publik i Qarkut në Prizren, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit për dënimin, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër;

- përfaqësuesi i palës së dëmtuar Sh. D., avokat B. S. nga Prizreni, për shkak të vendimit për dënimin, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër;

- i dëmtuari I. S., për shkak të vendimit për dënimin, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgimi afatgjatë, siç thekson, prej 40 (dyzet) vjetësh;

- përfaqësuesi i të dëmtuarës T. H., avokat R. K. nga Prizreni, për shkak të vendimit për dënimin, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër;

- i akuzuari M. H., pa i përcaktuar bazat ankimore, por siç del nga ankesa, atë e paraqet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'u kthehet gjyqtarëve ndërkombëtarë për rivendosje;

- mbrojtësi i të akuzuarit M. H., avokat H. K. nga Prizreni, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozimin që aktgjykimet e ankimuar të ndryshohen dhe i akuzuari të shpallet fajtor për një vepër penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 146 të KPK, të kryer ndaj të dëmtuarës L. H., një vepër penale të vrasje në gjendje të afektit mendor, të parashikuar nga neni 148 të KPK dhe një vepër penale vrasje në tentativë në gjendje të afektit mendor, të parashikuar nga neni 148 lidhur me nenin 20 të KPK, për të cilat t'i shqiptojë një dënim dukshëm më të butë, apo ta anulojë aktgjykimin dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme e mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Shtetit të Kosovës, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, i cili nuk prezantoi, por Gjykata Supreme sipas detyrës zyrtare, i angazhoi mbrojtësin av. A. A. nga Prishtina, i cili pasi sqaroi ca nga pretendimet që dalin nga ankesa, qëndroi në propozimet e bëra në të. I akuzuari qëndroi në pretendimet e veta ankimore dhe përkrahu ato të mbrojtësit të tij.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, edhe pse i njoftuar, nuk mori pjesë në seancën e kolegjit, por me parashtresën PPAI.nr. 10/2012 datë 23 dhjetor 2012, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut dhe ato të përfaqësuesve të palëve të dëmtuara të aprovohen, kurse ankesa e të akuzuarit dhe ajo e mbrojtësit të tij të refuzohen.

Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimet e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të paraqitura në ankesa, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Në ankesën e të akuzuarit dhe atë të mbrojtësit të tij pretendohet se aktgjykimet e ankimuar janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga dispozita e nenit 403 par. 1 pika 12 të KPPK, ngase, konstatimet "se janë bërë shkelje të ligjit, e që sipas gjykatës janë shkelje të parëndësishme dhe ato janë në favor të të akuzuarit" e bëjnë aktgjykimin e shkallës së dytë Ap.nr. 245/2010, datë 9 qershor 2011, të kundërligjshëm, gjë që kushtëzon anulimin e tij.

Në vazhdim, pretendohet se me aktgjykimin e shkallës së dytë refuzohet me lehtësi mbrojtja e të akuzuarit, duke arsyetuar çdo veprim,

kurse aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga pika 12 par. 1 të nenit 403 të KPPK, ngase i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale të cilësuar, por nuk ka shqiptuar dënime të veçanta, duke konsideruar se edhe vepra penale e parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK është konsumuar nga vepra penale e vrasjes së rëndë, të parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 11 të KPK, ndërsa rrethanat përkitazi me dënimin e shqiptuar paraqesin paqartësi, të cilat aktgjykimet e ankimuara i bëjnë konfuze e të pakuptueshme, gjë që kushtëzon anulimin e tyre.

Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme gjen se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimet e ankimuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të pretenduara në ankesa dhe as shkelje të tjera, të cilat ky Kolegj i vëren sipas detyrës zyrtare, ekzistimi i të cilave do të qonte në anulimin e tyre.

Qëndron fakti se, në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë i akuzuari është shpallur fajtor për tri vepra penale, për të theksuar se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, të parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 11 të KPK, për të cilat vepra penale nuk janë caktuar dënimet. Mirëpo, vlen të vihet në dukje pika 11 e par. 1 të nenit 147 të KPK, në të cilën theksohet: “me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë me nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi”, nga e cila rrjedh se kjo dispozitë ligjore nuk ka vetëm karakter ndëshkues, por e ka edhe karakterin cilësues, andaj në rastin konkret, nuk mund të caktohen dënimet për secilën nga këto vepra penale, por shqiptohet një dënim i vetëm.

Po ashtu, qëndron fakti se i akuzuari është shpallur fajtor edhe për një vepër penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK, për të cilën nga gjykata e shkallës së parë nuk është caktuar dënimi, ndërsa Gjykata Supreme, në aktgjykimin Ap.nr. 245/2010, datë 09.06.2011, ka konstatuar se është shkelur ligji penal në favor të të akuzuarit, duke i arsyetuar shkaqet, mirëpo kjo, aktgjykimin e ankimuar nuk e bën të paqartë, siç pa bazë pretendon mbrojtësi në ankesë.

Përkundrazi, dispozitivët e aktgjykimeve të ankimuara janë të qartë, nuk përmbajnë kundërthënie qoftë me vetveten, qoftë me arsyetimin e aktgjykimeve. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë, janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe ky Kolegj, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të paprovuara dhe duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 396 par. 7 të KPPK. Gjykata e shkallës së dytë, sikurse edhe ajo e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit

gjqësor, duke i paraqitur lidhur me to përfundimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe Kolegji i Veçantë i kësaj gjykate.

Mbrojtësi i të akuzuarit, përkitazi me bazën ankimore - vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në esencë, e konteston mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe përfundimet që i ka nxjerrë ajo në bazë të provave të administruara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme, gjë që kanë çuar edhe në përfundime të gabuara. Kështu, sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, e kanë vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, sepse i akuzuari M. H., ditën kritike, ndaj së ndjerës L. H., veprimet inkriminuese i ka ndërmarrë pasi që e ndjera nuk ia lëshon vajzën e tij, Sh., me ç'rast e privon atë nga jeta, ndërsa përkitazi me të ndjerin H. S. dhe të dëmtuarën T. H., veprimet inkriminuese i ka ndërmarrë në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij, në të cilën gjendje është sjellë nga sulmi i të ndjerit H. S. dhe të dëmtuarës T. H..

Kolegji i Veçantë i kësaj gjykate gjen se edhe këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë.

Sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, dalin të pakontestueshme rrethanat se:

- i akuzuari M. (S.) H. ka lindur në Ferizaj dhe si fëmijë i moshës 6 (gjashtë) muajsh është adoptuar nga O. H., nga fshati F., komuna e Shtërpcës;

- në vitin 1994 ishte martuar me M. M. nga Shkodra, me të cilën është divorcuar në vitin 2002; në këtë martesë ka 4 fëmijë dhe një fëmijë të bashkëshortes të cilën e ka adoptuar, për të cilët është kujdesur;

- M. M. tani ndodhet në një strehimore në Prizren, meqë vuan nga sëmundje psikike;

- e ndjera L. H. ka qenë e martuar më parë, në vitin 1997, me një person nga Kukësi-R. K., me të cilin ka pasur një vajzë të quajtur F. K.;

- në vitin 2002, përmes shkuesve, realizohet martesë e të akuzuarit M. H. me L. H. Në këtë martesë ata kanë dy fëmijë – Sh. (2003) dhe A. (2004), kurse vajzën e së ndjerës e adoptoi dhe i ndërroi emrin, mbiemrin dhe datëlindjen;

- pas martesës ata kanë jetuar në Prizren, në një shtëpi të uzurpuar të një serbi, (një vit e gjysmë);

- pas kësaj kohe shpërngulen për Kukës, ku jetojnë në një banesë me qira (rreth 1 –një- vit) dhe sërish kthehen në Prizren;

- se jeta bashkëshortore e tyre ka qenë e çrregulluar, për shkak të rrahjeve dhe maltretimeve që i ka bërë i akuzuari të ndjerës L. dhe vajzës nga martesja e parë;

- nuk është kontestuese se i akuzuari M., në vitin 2005, arrestohet në Maqedoni, për shkak të një veprë penale në Gostivar, ku qëndron në burg gjër më 11 dhjetor 2007;

- gjatë kësaj kohe e ndjera L., përmes Habitatit, vendoset në një banesë në lagjen “Ortakoll” në Prizren dhe se gjatë qëndrimit në burg, i vazhdon kërcënimet me letra ndaj të ndjerës;

- e dëmtuara T. H., (motra e së ndjerës L.), ishte e martuar për të ndjerin H. S. në vitin 2001, pa fëmijë,

- M. S., motra e të ndjerës L. – të dëmtuarës T., është e martuar për të birin e të ndjerit H., J., ndërsa Sh. D. është nëna e së ndjerës L. dhe e së dëmtuarës T.;

- pas kthimit nga burgu, bashkësia martesore vazhdon përsëri me të njëjtat çrregullime, saqë për konfliktet e tyre lajmërohen organet policore dhe e gjithë kjo çon në ndarjen e tyre;

- e ndjera L. merr vajzën nga martesja e parë, kurse në të njëjtën kohë, në Gjykatën Komonale në Prizren zhvillohet kontesti rreth dorëzimit të djalit, A., ashtu që me aktvendimit C.nr. 594/20088, datë 28.10.2008, caktohet masa mbrojtëse, duke iu urdhëruar të akuzuarit të mos i afrohet së ndjerës dhe fëmijëve të saj;

- i akuzuari M. ka ushtruar kallëzim penal kundër të ndjerës më 10.07.2008, për veprë penale të parashikuar nga neni 211 i KPK – keqtrajtim dhe braktisje e fëmijëve;

- më 24 janar 2008, në PPQ të Prizrenit kundër L., Sh., T., I. dhe H. për veprën penale nga neni 201 par. 1 – 3 lidhur me nenin 23 të KPK, kallëzimi penal nga Gjykata e Qarkut, hidhet poshtë me aktvendim si i palejueshëm;

- nuk është kontestuese se në Gjykatën e Qarkut në Prizren është duke u zhvilluar kontesti për shkurorëzim, i cili nuk ka përfunduar;

- e ndjera kishte shkuar në Kukës dhe se vinte vetëm në kohën e zhvillimit të kontesteve gjyqësore;

- një javë para rastit kritik, Gjykata Komunale në Prizren, me punonjësit e Qendrës për Punë Sociale, kishin pasur objekt shqyrtimi kthimin e të miturit, A., nënës së saj, tani të ndjerë dhe kishin shkuar në shtëpinë e të akuzuarit, por ekzekutimi nuk ishte kryer, sepse ishte shtyrë për ditën kritike, meqë i akuzuari ishte larguar nga shtëpia;

- ditën kritike, më 19.12.2008, e ndjera L., më nënën e saj, Sh., dhe vajzën, Sh., vijnë me një furgon nga Kukësi në shtëpinë e të ndjerit H. S., në Prizren;

- e ndjera L. me vajzën dhe motrën e saj, T., shkojnë në Gjykatën Komunale në Prizren, për të marrë pjesë në kontestin civil rreth marrjes së djalit, A. dhe njëkohësisht i akuzuari M. t'a shohë vajzën, Sh.;

- me provat e administruara vërtetohet se seanca e shqyrtimit shtyhet, për shkak të mosardhjes së të akuzuarit, edhe përkundër faktit se ishin prezentë punëtorët e Qendrës për Punë Sociale dhe punëtorja për mbrojtjen e viktimave;

- me të dalë nga ndërtesa e Gjykatës Komunale, e dëmtuara T. vëren djalin e të akuzuarit, M., i cili i përcillte para Gjykatës Komunale;

- sipas të dëmtuarës T., takojnë disa policë, nga të cilët kërkojnë që t'i dërgojnë në shtëpi, por ata refuzojnë, prandaj nisen në drejtim të stacionit të autobusëve, duke e njoftuar të ndjerin H. dhe takohen të gjithë së bashku;

- i ndjeri H. paguan një taksist, M. Ç., i cili niset në drejtim të shtëpisë së të ndjerit H.;

- me të arritur 10 metra afër shtëpisë së të ndjerit H., në rr. "D. S.", i akuzuari M., i cili kishte qenë duke pritur ardhjen e tyre prej orës 8:30, kur e vëren automjetin taksi me nr. të regjistrimit 142-KS-709, u del me armë përpara e pasi që automjeti taksi nuk ndalet, gjuan në drejtim të automjetit;

- vozitësi i automjetit taksi, M. Ç., kur sheh të akuzuarin, thotë: "Kuku, ky qenka me kallash", ndërsa i ndjeri H. saktëson: "Ja ku qenka M.", duke kërkuar që ta vozitë më shpejtë dhe të mos ndalojë automjetin, por ai ndalet;

- pas ndalimit të automjetit, vjen i akuzuari M., i cili hap derën e prapme të automjetit, duke e goditur L. me armën e përmendur, me ç'rast nga automjeti del i ndjeri H., në të cilin shtie duke e lënë të shtrirë përbri automjetit;

- e dëmtuara T., me të dalë nga automjeti, qëllohet me armë nga i akuzuari;

- vajza, Sh., ishte në prehrin e së ndjerës (nënës L.), por nuk qëllohet, ndërsa i akuzuari ikën në drejtim të panjohur.

Sikurse shihet, pretendimet ankimore se me aktgjykimet e ankimuar gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, sipas vlerësimit të Kolegjit të Veçantë, nuk janë të bazuara. Rrethanat relevante dhe vendimtare janë ato se i akuzuari që nga ora 8:30 e gjer në çastet e ardhjes së të ndjerëve me automjetin taksi, të cilin e ka drejtuar M. Ç., e ka pritur ardhjen e të ndjerëve dhe të dëmtuarës, se për përcjelljen e tyre ka angazhuar edhe djalin e tij, Mërgimin, për çka e dëmtuara T. detyrohet t'a ftojë të ndjerin H. S. që t'i marrë me automjetin taksi, por me të arritur afër shtëpisë së të ndjerit H., i akuzuari M., me armën e sipërpërmendur u del përpara që t'i ndalojë, e meqë automjeti taksi nuk ndalon, i akuzuari M. shtie në drejtim të tij, nga mbrapa, ndërsa kur ndalet automjeti, ai hap derën e prapme, ku ishte e ulur e ndjera L., të cilën e privon nga jeta me armën që kishte, pastaj, sapo kishte dalë nga automjeti, e privon nga jeta edhe të ndjerin H., e pastaj shtie edhe mbi të dëmtuarën T. dhe pas këtyre veprimeve të ndërmarra, largohet nga vendi i ngjarjes. Prandaj, pretendimi se të ndjerët H. dhe L., si dhe e dëmtuara T., të akuzuarin e kanë sjellë në një gjendje të tronditjes së fortë psikike, të shkaktuar pa fajin e vet, është qartazi i pabazë dhe pa kurrfarë mbështetjeje në provat e administruara.

Prandaj, në praninë e kësaj gjendjeje faktike, dalin si të drejta dhe të bazuara konkludimet, si të gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe asaj të shkallës së dytë, se në veprimet inkriminuese të të akuzuarit realizohen tiparet e veprës penale të vrasjes së rëndë, të parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 11 të KPK dhe të një vepre penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK. Pra, del se drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e Kodit Penal. Nga kjo rezulton se nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Duke e vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Kolegji i Veçantë i kësaj gjykate konstaton se me të drejtë theksohet në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Prizren dhe ankesat e përfaqësuesve të palëve të dëmtuara, se dënimi i shqiptuar është i butë. Rrethanat lehtësuese, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë, përkatësisht se i akuzuari ka një numër të madh të fëmijëve edhe jashtë kësaj martese, se ka çrregullim të personalitetit, se ka shfaqur pendim të thellë për veprimet që ka ndërmarrë dhe keqardhje për fëmijët e tij që kanë mbetur pa prindër, ndërsa si rrethana rënduese ka pasur parasysh numrin e madh të personave të dëmtuar, gatishmërinë që të ndërmarrë veprime të tilla të rrezikshme në vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale (në vend publik), ku ka pasur qarkullim të madh të njerëzve, paskrupullësinë e shprehur me atë rast, motivet e ulëta dhe të paarsyeshme që e kanë drejtuar në ndërmarrjen e këtyre

veprimeve inkriminuese, ndërsa në ankesën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij nuk theksohen rrethana të tjera lehtësuese, të cilat nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, prandaj duke i vlerësuar pretendimet ankimore të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren dhe ato të përfaqësuesve të palëve të dëmtuara për mënyrën dhe rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke përfshirë prezencën e vajzës së mitur, Sh., e cila ndodhej në prehërin e së ndjerës L., Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar si në diapozitiv, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit, i parashikuar nga dispozita e nenit 34 të KPK.

Nga sa u tha më lartë dhe konform dispozitës së nenit 426 të KPPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Api.nr.10/2011, më 15 mars 2012,

Procesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri

1. _____
Avdi Dinaj

2. _____
Meleqe Behxheti

3. _____
Nebojsa Boriçiq

4. _____
Nazmije Ibrahim